

**INSTITUTI I EKSPERTEVE KONTABEL TE REGJISTRUAR
EKSPERTE KONTABEL E REGJISTRUAR ELEDA DHIMA**

**AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE
PER PERIUDHEN 1 JANAR- 31 DHJETOR 2014
PER PARTINE E PUNES SHQIPTARE**



NENTOR 2015

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVOUR

Drejtuar : Komisionit Qendror te Zgjedhjeve

(Pallati i Kongreseve) Tirane

Partia e Punes Shqiptare

Te Nderuar Zoterinj:

Kemi audituar Pasqyrat financiare bashkelidhur te Partise se Punes Shqiptare, te cilat perfshijne bilancin kontabel per fondet e perfituara dhe te shpenzuara gjate vitit 2014, pasqyrat perkatese te te ardhurave dhe shpenzimeve, per kete ushtrim, si dhe nje permbledhje te metodave kontabel te rendesishme dhe shenime te tjera ne lidhje me to (anekse).

Pergatitja dhe paraqitja e sinqerte e ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit eshte pergjegjesi e drejtimit te partise. Kjo pergjegjesi perfshin: hartimin, venien ne zbatim dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem te pershtatshem per pergatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave financiare qe jane pa anomali materiale, qofte per shkak te mashtrimit ose te gabimit; per te zgjedhur dhe zbatuar metodat e pershtatshme kontabel; si dhe per te bere çmuarjet kontabel qe jane te arsyeshme per rrethanat e dhena.

Pergjegjesia jone eshte qe, bazuar ne auditimin e kryer, te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare. Ne kemi kryer auditimin ne pajtim me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te zbatojme kerkesat etike dhe te planifikojme dhe kryejme auditimin tone per te mare sigurine e arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk permbajne anomali materiale.

Auditimi perfshin ekzaminimin, mbi bazen e testeve, te evidences qe mbeshtet shumat dhe informacionet e dhena ne pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit te audituesit, duke perfshire vleresimin e rreziqeve per anomali materiale ne pasqyrat financiare, qofte per shkak te mashtrimit ose te gabimit. Ne berjen e ketyre vlersimeve te rrezikut, audituesi merr ne konsiderate kontrollin e brendshem perkates te shoqerise ne pergatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet te pasqyrave financiare ne menyre qe te hartoje procedurat e auditimit qe jane te pershtatshme per rrethanat, por jo per qellimin e shprehjes se opinionit per efektiviten e kontrollit te brendshem te shoqerise. Auditimi perfshin gjithashtu, vleresimin e parimeve kontabel te perdorura dhe te llogjikene e çmuarjeve te rendesishme te bera nga Drejtimi, si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjitheshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme se evidenca e auditimit qe ne kemi marre eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te dhene bazat e opinionit tone te auditimit.

Pasqyrat financiare jane pergatitur ne baze te parimit te arketim pagesave dhe jo ne baze te te drejtave te konstatuara.

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare te pergatitura, me nje besueshmeri te aresyeshme japin nje pamje te vertete dhe te sinqerte per gjendjet financiare te Partise se Punes Shqiptare ne vitin 2014, te rezultatit financiar dhe flukseve te parave per ushtrimin e mbyllur, ne perputhje me Ligji nr.8580, dt.17.02.2001 “Për partitë politike”, i ndryshuar dhe Ligjin 9228 date 29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Eleda Dhima

Eksperte Kontabël e Regjistruar
Lic. Nr. 197 dt. 30.01.2009

Tirane, me 10.11. 2015

*SHENIME PLOTESUESE NE LIDHJE ME AUDITIMIN E PARTISE SE PUNES SHQIPTARE
PER FONDET E PERFITUARA DHE TE SHPENZUARA PER VITIN 2014*

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

Baza ligjore per kryerjen e ketij misioni është marrë në referim të ligjeve:

- Ligji nr.8580, dt.17.02.2001 “Për partitë politike”, i ndryshuar.
- Ligji nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës se Shqipërisë”.
- Ligji nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar”, Standartet Ndërkombetare të auditimit dhe kryesisht (SNA 800).
- Ligji Nr. 9228 date 29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Finnciare”
- Çdo dokument ligjor të marrë prane Partisë se Punes Shqiptare.
- Vendimi Nr. 969 date 10.08.2015 i Komisionit Qendror te Zgjedhjeve
-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Partia e Punes Shqiptare eshte regjistruar me Vendim te Gjykates Rrethit Gjyqesor Tirane, sipas dispozitave perkatese te Ligjit nr. 8580, dt.17.02.2001 “Per Partitë Politike”, të Ligjit nr.8788, dt.07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimpruese “, të Ligjit nr.8779, dt.07.05.2001 “Për Regjistrimi e Organizatave Jofitimpruese”, nga statuti i saj dhe legjiacioni ne fuqi. Kryetar i saj eshte Z. Muharrem Xhafa i cili është i autorizuar të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme për aktivitetin normal të partise. Qëllimi dhe objektivat e kësaj Partie gjejnë pasqyrim të qartë në Programin dhe Statutin e saj. Subjekti zgjedhor Partia e Punes Shqiptare është një bashkim politik i qytetarëve shqiptarë e cila e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë. Qendra e Partisë se Punes Shqiptare është ne Tirane por nuk kane nje seli te qendrushme, mbledhjet behen ne lokale te ndryshme per marren e vendimeve.

Burimet e financimit te Partise jane:

- Ndhimat dhe dhuratat e antaresise dhe te perkrahesve
- Çdo e ardhur tjetër që nuk bie në kundërshtim me ligjislacionin për financimin e partive politike.

MËNYRA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare janë përgatitur, në përputhje me Normat Kombëtare të Raportimit Financiar (NKRF), të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin nr.9228 dt. 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare“ ne baze te parimit te arketim pageses.

Rregullat e vlerësimit të likuiditeteve

Gjendjet e likuiditeteve përfshijne gjendjen e parave në arkë dhe në llogaritë rrjedhese në bankë në leke. U kontrolluan veprimet e kryera në arkë dhe bankë dhe u konstatuan se regjistrimet në librat e llogarive dhe në ditarët përkatës ishin kryer sipas normave kontabël.

Të ardhurat regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre nga dontorët dhe perdorimi i tyre është sipas planit të buxhetit të financuar nga projekti.

Organizimi i Kontabilitetit

Kontabiliteti është i organizuar në përputhje me ligjin “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare” sipas parimit të arketim pagesave. Partia ka ndertuar nje plan të llogarive vetjake në përputhje të plote me planin unik kontabël. Kontabiliteti mbahet në menyre manuale. Per vitin 2014 Partia e Punes Shqiptare nuk ka realizuar të ardhura dhe shpenzime.

PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

A. Te ardhura te perfituara ne shumen 0.00 Leke ,

B. Te shpenzuara ne shumen 0.00 Leke ,

Shumat e mesiperme si per te ardhurat e perfituara dhe te shpenzuara, per vitin 2014 konfirmohen edhe nga deklarata date 10.11.2015, e leshuar nga Z. Muharrem Xhafa ne cilesine e kryetarit te Partise se Punes Shqiptare

Gjendja e Likuiditeteve :

Ne mbyllje te vitit gjendja e likuiditeve ne llogarite bankare dhe ne arke eshte 0.00 Leke.

Ngjarje te mevonshme

Nuk ka patur ngjarje te mevonshme qe mund te influencojne ne pasqyrat financiare te mesiperme.

Eleda Dhima

Eksperte Kontabël e Regjistruar

Lic. Nr.197 dt. 30.01.2009

Tirane, me 10/11/2015